



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.09.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 102/205 “Për sektorin e gazit natyror”.

(Komision përgjegjës)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermeni, Andrea Marto, Rakip Suli, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka, Fadil Nasufi dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Gjetan Gjetani, Florion Mima, Endri Hasa, Lorenc Luka, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Agron Çela dhe Lefter Koka.

Të ftuar:

Dorina Cinari – Zvministre e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ilir Bejtja – Këshilltar i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Përshëndetje, të nderuar kolegë deputetë!

Siç ju kemi vënë në dijeni, sot kemi për diskutim projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

Relator i këtij projektligji është zoti Baraj. Të ftuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë kemi zonjën Dorina Cinari, zëvendësministre dhe zotin Ilir Bejtja, të cilëve u uroj mirëseardhjen në komision.

Pa humbur kohë, fjalën e ka zoti Baraj, më pas përfaqësuesit e ministrisë dhe në fund do të procedojmë me pyetje dhe diskutime. Dakord me rendin e ditës?

Besnik Baraj – Faleminderit, zoti kryetar!

Qëllimi i këtij projektligji është ndryshimi i pikës së dytë të nenit 89 të ligjit nr. 102 “Për sektorin e gazit natyror”. Duke vlerësuar në tërësi përmbajtjen e nenit 89, të ligjit nr.102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, është evidente që përmbajtja e fjalisë së parë të pikës 2, të nenit 89, konsiderohet si gabim/lapsus, për sa ka të bëjë me shprehjen “miraton kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit”, pasi në këtë rast objekti i nenit 89 ka të bëjë me miratimin e kushteve dhe të procedurave për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, gjë për të cilën do të duhet të bëhet ndryshimi përkatës në formulimin e fjalisë së parë të pikës 2, të nenit 89, të ligjit nr.102/2015.

Për këtë arsye, në ndryshimin që propozohet të bëhet në ligjin nr.102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, kërkohet që fjalia e parë e pikës 2, të nenit 89, të ligjit nr.102/2015, të formulohet “2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton kushtet dhe procedurat për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik.”.

Mendoj dhe ftoj kolegët ta votojmë këtë ndryshim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Atëherë, e mbyllim diskutimin mbi projektligjin. Kalojmë në votim.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 1.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi? Kundër? Abstenim?

Miratohet në tërësi projektligji.

MBYLLET MBLEDHJA